



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 15. 06. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Ibrahim Makolli, Ibrahim Selmani, Danush Ademi dhe Drita Maliqi.

Munguan: Luljeta Shehu dhe Shpresa Murati.

Pjesëmarrës të tjerë: Xhemajl Ahmeti - OHCHR, Lejla Selimi – OSBE dhe Besnik Ramadani – KDI.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e saj.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendi të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 15. 06. 2010,
3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës së Komisionit,
4. Shqyrtimi i kërkesave,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më
01. 06. 2010**

Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 01. 06. 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i realizimit të planit të punës të Komisionit

Fatmir Rexhepi, kryetar - I përshëndeti të pranishmit dhe ata që i monitorojnë mbledhjet e Komisionit. Ai tha se kjo mbledhje ka për qëllim që të informohemi se deri ku janë proceduar çështjet që bien në fushëveprimin e punës së Komisionit. Prandaj, si anëtarë ju jeni familjarizuar me punën që e bënë ky Komision, qoftë me planin e punës ose me pikat që e ngarkon plani i veprimit për integritet. Ne gjendemi në fund të muajit, e pashë të arsyeshme që të konsultohemi paraprakisht se sa është realizuar plani i paraparë për këtë periudhë dhe bashkërisht të hartojmë planin e punës edhe për gjashtëmujorin e ardhshëm. Në fund i ftoi anëtarët ta marrin fjalën.

Hajredin Hyseni - Tha se Komisioni për gjashtëmujorin e parë, nuk e ka realizuar planin, gjë që nuk është bërë me fajin e tij. Pra, pik kyçe është edhe Projektligji për të pagjeturit, e që ka mbetur pezull. Ne jemi zotuar se në qoftë se Qeveria nuk e procedon këtë P/ligj, kemi thënë ta hartojmë ne, si Komision, pasi kemi kapacitete dhe resurse humane për hartimin e tij. Ai i kërkoi Komisionit, që në planin e punës për gjashtëmujorin e dytë të përfshihet edhe kjo çështje.

Ibrahim Makolli - Theksoi se është realizuar plani punës, prandaj çështjet e trashëguara, si ajo e P/ligjit për të pagjeturit është përfunduar dhe gjendet në Qeveri, por insistimi i ndërkombëtareve është që të zhdukurit gjatë luftës të figurojnë të zhdukurit deri më 31 dhjetor 1999, e që për ne është e pa pranueshme, sepse konflikti në Kosovë, siç e quajnë ndërkombëtarët, ka përfunduar më 12 qershor 1999, pas kësaj date nuk mund të konsiderohen të zhdukur në luftë.

Ai tha se më mirë është që të mos ketë fare ligj, sesa një ligj që do të sillte pasoja të mëdha politike.

Rrahim Demaj – Në vija të trasha e informoi Komisionin me zbatimin e planit të punës për gjashtëmujorin e parë, duke vlerësuar se Komisioni i ka përmbushur pikat bashkë me pikat e planit të veprimit. Komisioni ka organizuar dëgjime publike dhe ka shqyrtuar peticione, që kanë të bëjnë me kërkesat e qytetarëve, pensionistëve, moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme nga ana e institucioneve të Kosovës, të dhëna nga KPMK – ja.

Drita Maliqi – Tha se do të ishte më e përshtatshme të formohej një grup punues që ta përgatit draftin e parë dhe të prezantohet në Komision për miratim. Kryetari duke u bazuar në rregullat e Rregullores së punës së Kuvendit i propozoi Komisionit për formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Komisionit për gjashtëmujorin e dytë të 2010 dhe nxori këtë

V e n d i m

I. Formohet grupi punues me këtë përbërje:

- Fatmir Rexhepi, kryetar,
- Nerxhivane Dauti, zëvendëskryetare dhe
- Ibrahim Makolli anëtar.

II. Grupi punues e ka për detyrë hartimin e planit të punës të Komisionit për gjashtëmujorin e dytë të viti 2010.

4. Shqyrtimi i kërkesave

Nerxhivane Dauti - Në cilësi të raportueses lidhur me ankesën e H. Sh. nga Barileva, KK Prishtinë, e njoftoi Komisionin për parregullsitë lidhur me zgjidhjen e kontestit për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar në fatkeqësinë që ka pasur në komunikacion, duke shkuar në punë, më 02. 04. 2000.

Ai në mënyrë kronologjike e përshkruan çështjen juridiko - kontestuese, për të cilën konsideron se Gjykata Komunale e Prishtinës, në aktgjykimin nr. C. nr. 1946/08, të datës 22. 10. 2009, nuk e ka shqyrtuar drejt ankesën sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

Prandaj bazuar në nenin 62, pika 1, të Rregullores të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës i propozoi Komisionit të nxjerrë këtë:

P e r f u n d i m

Komisioni konstaton se çështja e ngritur nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon që t'i drejtohet gjykatës për përshpejtimin e procedurës .

a) Shqyrtimi i kërkesës së punëtorëve të bufesë së Kuvendit

Ibrahim Makolli - I raportoi Komisionit lidhur me shkresën e punëtorëve të byfës së Kuvendit lidhur me kërkesat tyre. Pas një debati Komisioni vendosi që në mbledhjen e ardhshme grupi punës ta hartojë shkresën bashkë me arsyetimin dhe t'ia procedojë sekretarit të Kuvendit.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë u ngritën dy çështje:

- *Lidhur me raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit rreth trafikimit me qenie njerëzore.*
- *Nevoja e interpretimit të neneve 57 dhe 69 të Rregullores të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.*

Ibrahim Makolli - Bëri një koment rreth raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili është shqetësues lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, duke e cilësuar Kosovën si burim i trafikimit, për dallim nga raportet e kaluara që konsiderohej si vend i transitit. Ishte i mendimit që, si Komision, të mbajmë një takim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku do të ftohej edhe Njësi i Policisë së Kosovës që merret me këtë fushë, ku do të debatohej rreth zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore 2008 - 2011.

Nerxhivane Dauti - U pajtua me parafolësin me çështjen e ngritur duke shtuar se do të duhej që fillimisht të mbajmë një takim me zëvendësministrin në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe pas këtij takimi të organizojmë edhe një dëgjim publik, ku do të ftohej Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Punë dhe Mirëqenie sociale, OJQ - të dhe grupet e tjera të interesit. Me propozimin e saj është pajtuar edhe Hajredin Hyseni.

Pas diskutimeve konstruktive që u zhvilluan, Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Komisioni, është pajtuar që më 22. 06. 2010, të ftojë Fatmir Xhelilin, zëvendësministër. Informatë mbi gjendjen, masat dhe veprimet kundër trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë.

- *Kërkesë e interpretimit të neneve 57 dhe 69 të Rregullores të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës*

Ibrahim Makolli - Në fjalën e tij ngriti çështjen lidhur me nenin 57 të Rregullores të punës së Kuvendit. Ky Komisionin është paraparë, si Komision i përhershëm, ndërsa në nenin 69 nuk radhitet si Komision i përhershëm dhe si duket ka një mospërputhje. Ishte i mendimit që t'i drejtohem Kryesisë së Kuvendit që të shikohet kjo çështje, që edhe në nenin 69 të përfshihet si Komision i përhershëm.

Komisioni e përkrahu dhe ishte konstatim i përgjithshëm që të kërkohet nga Kryesia Kuvendit interpretimi dhe harmonizimi i këtyre dy neneve.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 20.

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi